



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



UJËSJELLËS KANALIZIME TIRANË SH.A DEPARTAMENTI I SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE DREJTORIA E PROKURIMEVE



Nr. _____ Prot.

Tiranë, më ____/____/2018

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

Për: Bashkimi i Operatorëve ekonomik, “Vuthaj shpk & Ndregjoni shpk” sh.p.k, përfaqësuar me prokurë të posaçme nr.4126 rep. dhe nr.3351 kol. Datë 22.05.2018 nga shoqëria “Vuthaj shpk me NIPT-i K67812301C me administrator, Z.Fatmir Vuthaj, me seli në Adresën: Autostrada Skuraj, Milot, km 1.

Lloji i procedurës së prokurimit: Procedure e Hapur

Objekti i kontratës/marrëveshjes kuadër: “Rikonstruksion rrjet Kanalizimi në Rrugën “Qazim Vathi”

Numri i referencës së procedurës/lotit: REF-64122-04-20-2018

Fondi limit: 22.300.628 (njëzet e dy milion e treqind mijë e gjashtëqind e njëzet e tetë) lekë pa TVSH.

Kohëzgjatja e kontratës ose afati kohor për ekzekutimin: 60 ditë duke nisur nga data e dorëzimit të sheshit të punimeve.

Burimi i financimit: Të ardhurat e SH.A Ujësjiellës-Kanalizime, Tiranë.

Data e zhvillimit të tenderit është: 29.05.2018 Ora: 09:00

Buletini i Njoftimeve Publike: Nr. 17 datë 30.04.2018

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët X oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojmë se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. B.O.E “EURONDERTIMI 2000”sh.p.k NIPT-i K02003001O
Vlera: 15.458.709 (pesëmbëdhjetë milion e katërqind e pesëdhjetë e tetë mijë e shtatëqind e nëntë) lekë pa TVSH.

2. Operatori ekonomik “B-93” sh.p.k. NIPT-i J62903508R
Vlera: 16.263.981(gjashtëmbëdhjetë milion e dyqind e gjashtëdhjetë e tre mijë e nëntëqind e tetëdhjetë e një) lekë pa TVSH.
3. Operatori ekonomik “LIQENI VII” sh.p.k. NIPT-i K01730502Ë
Vlera: 17.346.662 (shtatëmbëdhjetë milion e treqind e dyzetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e dy) lekë pa TVSH.
4. Operatori ekonomik “S I R E T A 2F” sh.p.k. NIPT-i K51501008J
Vlera: 19.999.999 (nëntëmbëdhjetë milion e nëntëqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e nëntë) lekë pa TVSH.
5. Operatori ekonomik “Gjiguria” sh.p.k. NIPT-i J62903456H
Vlera: 20.093.703 (njëzetë milion e nëntëdhjetë e tre mijë e shtatëqind e tre) lekë pa TVSH
6. Bashkimi i operatoreve ekonomik “NDREGJONI” sh.p.k. NIPT-i K31329048I
&”VUTHAJ” sh.p.k. NIPT-i K67812301C
Vlera: 20.492.945 (njëzetë milion e katërqind e nëntëdhjetë e dy mijë e nëntëqind e dyzetë e pesë) lekë pa TVSH.
7. Operatori ekonomik “REJ” sh.p.k. NIPT-i J93711608
Vlera: 20.547.237 (njëzetë milion e pesëqind e dyzetë e shtatë mijë e dyqind e tridhjetë e shtatë) lekë pa TVSH.
8. Operatori ekonomik “FLED” sh.p.k. me vlerë të ofertës 21.620.708 (njëzetë e një milion e gjashtëqind e njëzetë mijë e shtatëqind e tetë) lekë pa TVSH.
9. Operatori ekonomik “KOLA INVEST ” shpk NIPT-i K93103401G
Vlera: Nuk ka paraqitur oferte ekonomike.

Të skualifikuar:

1. Oferta e paraqitur nga Operatori Ekonomik “EURONDERTIMI 2000” sh.p.k. me vlerë të ofertës 15.458.709 (pesëmbëdhjetë milion e katërqind e pesëdhjetë e tetë mijë e shtatëqind e nëntë) lekë pa TVSH.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave pasi realizoi kontrollin për gabime aritmetike të ofertës së paraqitur në tender në mbështetje të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”I ndryshuar neni 66, konstatoi se oferta është paraqitur pa gabime aritmetike në vlera.

Në mbështetje të Ligjit Nr. 9643, date 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) Neni 56 dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu VII, Neni 66, pika 5, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave referuar formulës së përcaktuar në dokumentat e tenderit verifikoi nëse oferta e vlefshme është me çmim Anomalisht të Ulët nga ku rezultoi se oferta është në kushtet e Ofertës Anomalisht të Ulët.

KVO konstatoi se oferta e paraqitur nga Operatorit Ekonomik “EURONDERTIMI 2000” shpk është anomalisht e ulët.

Me datë 01.06.2018 Komisioni i Vlersimit të ofertave i ka dërguar mesazh Operatorit Ekonomik “EURONDERTIMI 2000” shpk në sistemin elektronik të APP se me lëndë “Kërkesë për shpjegime për elementë të veçanta të ofertës”, si më poshtë:

Gjate shqyrtimit të ofertave nga Komisioni i Vleresimit të Ofertave për objektin “Rikonstruksion rrjet kanalizimi në Rrugën Qazim Vathi” sipas formulës së përcaktuar në DST u vërejt se oferta e paraqitur nga ana juaj me vlerë 15.458.709 (pesëmbëdhjetë milion e katërqind e pesëdhjetë e tetë mijë e shtatëqind e nëntë) lekë pa TVSH, është anomalisht e ulët.

Ne zbatim të nenit 56 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar shprehimisht thuhet.....

1) Kur AK verën se një ose me shumë oferta për kontratat e mallrave, puneve apo shërbimeve janë anomalisht të ulëta ai përpara se të vazhdojë me procesin e vleresimit të ofertave i kërkon operatorit ekonomik përkatës të paraqesë me shkrim dhe brenda 3 ditëve pune shpjegime për elementet e vecante të ofertës për:

a) anën ekonomike të metodës së ndërtimit, procesit të prodhimit apo shërbimeve të ofruara

b) zgjidhjet teknike të ofruara dhe ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm që ka ofertuesi për kryerjen e punimeve, për furnizimin e mallrave apo të shërbimeve

c) origjinalitetin e puneve, mallrave apo të shërbimeve të propozuara nga ofertuesi

d) zbatueshmërinë e detyrimeve që lidhen me mbrojtjen në punë dhe kushtet e punës në vendin ku do të kryhet apo ku do të sigurohet furnizimi....

Në keto kushte në zbatim të përcaktimit të dispozitave të mesipërme, duhet të paraqisni brenda afatit 3 ditor argumentimin e çmimit të ofertës me shkrim shoqëruar me dokumentacionin provues pranë Autoritetit Kontraktor UKT sh.a.

Mosrespektimi i kërkesës së mësipërme nga ana juaj përbën kusht skualifikimi.

Operatorin ekonomik “EURONDERTIMI 2000” shpk ka kthyer përgjigje me anë të shkresës Nr.14920 Prot, Datë 04.06.2018 me lëndë: “Sqarim oferte anomalisht e ulët për prokurimin me objektin : “Rikonstruksion rrjet Kanalizimi në Rrugën “Qazim Vathi”.

Komisioni i Vlersimit të Ofertave informon operatorin ekonomik si më poshtë:

Në përgjigje të kërkesës suaj protokolluar në protokollin tonë me nr.14920 prot. datë 04.06.2018, për sqarim të ofertës ekonomike Anomalisht e ulët për të dhënë shpjegime për elementët e vecantë të ofertës për të vijuar më tej me procedurën, ju informojmë se:

Komisioni i vlerësimit të ofertave konstatoi se operatori ekonomik ka dorëzuar sqarime ekonomike për ofertën anomalisht të ulët kun ë të cilën në analizat e çmimeve të paraqitura për justifikimin dhe argumentimin e zërave të punimeve çmimi i zërit të punimeve për puntoritë është paraqitur me 125 lekë ora, ku në mbështetje të Vendimit Nr. 399, datë 3.5.2017 “Për Përcaktimin E Pagës Minimale Në Shkallë Vendi”, përcaktohet shprehimisht: “Paga bazë minimale, mujore, për punonjësit, në shkallë vendi, që është e detyrueshme të zbatohet nga çdo person juridik a fizik, vendas ose i huaj, të jetë 24 000 (njëzet e katër mijë) lekë. Paga bazë minimale mujore jepet për 174 orë pune në muaj, të kryera gjatë kohës normale të punës. Paga bazë minimale, orare, të jetë 138 (njëqind e tridhjetë e tetë) lekë”. Pra, duke qenë se paga orare minimale duhet të jetë 138 (njëqind e tridhjetë e tetë) lekë , llogaritjet e bëra në analizat e kostos të operatorit Ekonomik të mësipërm për pagën orare në masën 125 lekë, bien në kundërshtim me vendimin e mësipërm.

Nga ana e komisionit të vlerësimit të ofertave gjykohet se operatori ekonomik, për pretendimet e ngritura në sqarimin e paraqitur në lidhje me:

a. Anën ekonomike të metodës së ndërtimit, procesit të prodhimit ose të shërbimeve të ofruara,

- gjëndjen e mallrave në magazinë .
- b. Zgjidhjet teknike të ofruara dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm, që ka ofertuesi për kryerjen e punimeve, për furnizimin e mallrave apo të shërbimeve;
 - c. Origjinalitetin e punëve, mallrave apo të shërbimeve, të propozuara nga ofertuesi;
 - d. Zbatueshmërinë e detyrimeve, që lidhen me mbrojtjen në punë dhe kushtet e punës, në vendin ku do të kryhet puna, shërbimi apo ku do të sigurohet furnizimi.

Këto të fundit nuk janë të justifikueshme me materiale shkresore ku të tregohen qartë kontratat për furnizim apo kryerjen e shërbimeve perkatese me cmimet perkatese, si dhe gjëndjen e materialeve të gatshme për përdorim sikurse i referohet operatori ekonomik.

Si rrjedhojë justifikimi i dhënë nuk është bindës dhe i dokumentuar me forma shkresore dhe ekonomike për të justifikimin e ofertes anomalisht të ulët.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte e shpall të pa vlefshme këtë ofertë.

2. Oferta e paraqitur nga operatori ekonomik “B-93” sh.p.k., me vlerë të ofertës 16.263.981 (gjashtëmbëdhjetë milion e dyqind e gjashtëdhjetë e tre mijë e nëntëqind e tetëdhjetë e një) lekë pa TVSH

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave pasi realizoi kontrollin për gabime aritmetike të ofertës së paraqitur në tender në mbështetje të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik” I ndryshuar neni 66, konstatoi se oferta është paraqitur pa gabime aritmetike në vlera.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në mbështetje të nenit 53 të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, për “Prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe Kreut VII, neni 66, pika 3 të VKM Nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar si dhe dokumentave të tenderit të miratuara, vijoi me shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertës së paraqitur nga ky Operator ekonomik, nga ku rezultoi si më poshtë:

- *Autoriteti kontraktor në Dokumentat Standarte të Tenderit tek Kriteret e Veçanta të Kualifikimit/ Kapaciteti teknik ka kërkuar si më poshtë:*

5. Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar staf teknik për kryerjen e të gjitha punimeve në këtë objekt, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, diplomë, CV, librezat e punës, si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë për të paktën 3 (tre) muajt e fundit stafi inxhinierik si më poshtë:

- 1(një) inxhinierë Ndërtimi
- 1(një) inxhinier Elektrik
- 1(një) inxhinier Hidroteknik
- 1(një) Inxhinier topograf
- 1(një) inxhinier Mjedisi (i pajisur me certifikatë lëshuar nga Ministria e Mjedisit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedisi)

Operatori ekonomik “B-93” sh.p.k në përmbushje të kriterit të mësipërm ka paraqitur Inxhinierin e mjedisit Z.F.H i cili nuk figuron në listpagesat e shoqërisë për të paktën 3 muajt e fundit konformë kriterit të mësipërm të kërkuar nga AK në dokumentat standarte të tenderit. Gjithashtu operatori ekonomik ka paraqitur në sistemin elektronik të app-së Znj.me initiale O.C si inxhinier mjedisi e cila figuron në listpagesat e shoqërisë për tre muajt e fundit por nuk ka paraqitur për zonjën me initialet O.C certifikatë lëshuar nga Ministria e Mjedisit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedisi.

Pra sa më sipër cituar dokumentacioni i paraqitur nga Operatori Ekonomik lidhur me *inxhinier*

Mjedisi (i pajisur me çertifikatë lëshuar nga Ministria e Mjedisit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis) është I paplotë për rrjedhojë do të konsiderohet i pavlefshëm.

- Autoriteti kontraktor në Dokumentat Standarte të Tenderit tek Kriteret e Veçanta të Kualifikimit/ Kapaciteti teknik ka kërkuar si më poshtë:

9. Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar minimalisht 2(dy) punonjës manovratorë të mjetëve të rënda nga te cilet një automakiniste dhe një eskavatoriste. Për këto punonjës duhet të paraqitet kontrata e punës e vlefshme, dëshmite e drejtimit (të vlefshme), lëshuar nga institucionet përkatëse si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë për tre muajt e fundit.

Operatori ekonomik “B-93” sh.p.k në përmbushje të kriterit të mësipërm ka paraqitur:

A.D manovrator (nuk ka dëshmi drejtimi për eskavatorist)

A.Z manovrator (me dëshmi drejtimi të vlefshme për eskavatorist)

I.S manovrator (me dëshmi drejtimi të vlefshme për eskavatorist)

A.S manovrator (me dëshmi drejtimi të vlefshme për eskavatorist)

Sa më sipër Operatori Ekonomik nuk ka paraqitur asnjë punonjës manovrator të paisur me dëshmi drejtimi të vlefshme për automakinist.

Për sa më sipër Dokumentacioni i paraqitur nga Operatori Ekonomikë “ B-93” shpk është i paplotë pasi nuk ka përmbushur kriteret e Veçanta të Kualifikimit/ Kapaciteti Teknik duke mos paraqitur punonjësit manovrator/ automakinist (copë 1) të kërkuar nga AK;

Pra sa më sipër Shoqëria “ B-93” shpk nuk zotëron kapacitet të mjaftueshem teknik për sa i përket personelit të nevojshëm për të realizuar kontratën për këtë objekt prokurimi duke mos përmbushur Kriteret e veçanta për kualifikim, Kapaciteti Teknik dhe profesional, , eka bie në kundërshtim me pikën 1 gërma (a) dhe (b) të nenit 46 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik” i ndryshuar ku përcaktohet se: *Operatorët ekonomik, për të marrë pjesë*

në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtëme që AK i vlerëson të nevojshme.....

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të Nenit 53 pika 5, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për Prokurimin publik” (i ndryshuar) dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu VII, Neni 66 pika 3, e shpall të pavlefshme këtë ofertë pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

3. Oferta e paraqitur nga operatori ekonomik “LIQENI VII” sh.p.k..me vlerë të ofertës 17.346.662 (shtatëmbëdhjetë milion e treqind e dyzetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e dy) lekë pa tvsh

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave pasi realizoi kontrollin për gabime aritmetike të ofertës së paraqitur në tender në mbështetje të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik” I ndryshuar neni 66, konstatoi se oferta është paraqitur pa gabime aritmetike në vlera.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në mbështetje të nenit 53 të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, për

“Prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe Kreut VII, neni 66, pika 3 të VKM Nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar si dhe dokumentave të tenderit të miratuara, vijoi me shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertës së paraqitur nga ky Operator ekonomik, nga ku rezultoi si më poshtë:

- *Autoriteti kontraktor në Dokumentat Standarte të Tenderit tek Kriteret e Veçanta të Kualifikimit/ Kapaciteti teknik ka kërkuar si më poshtë:*

18.Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratë (Shtojca 10).

<i>Mjetet</i>	<i>Sasia</i>	<i>Gjendja</i>
Kamion vetëshkarkues (kapaciteti mbajtës minimum 5(pese) ton dhe maksimumi 10(dhjetë) ton për secilin kamion	2 copë	Pronësi ose me qera
Fadrome me goma	1 copë	Pronësi ose me qera
Eskavator me goma 0.25 m3	1 copë	Pronësi ose me qera
Kamion vetëshkarkues (kapaciteti mbajtës minimum 15(pesëmbëdhjetë) ton dhe maksimumi 20(njëzetë) ton për secilin kamion	2 copë	Pronësi ose me qera
Autobetoniere	3 copë	Pronësi ose me qera
Autovinc	1 cope	Pronësi ose me qera
Pompë uji	1 copë	Pronësi ose me qera
Kamionçine (kapaciteti mbajtës minimum 1(nje) ton dhe maksimumi 2(dy) ton për secilin kamionçinë	2 cope	Pronësi ose me qera
Prerese asfalti	2 cope	Pronësi ose me qera
Rrul	1 cope	Pronësi ose me qera

Operatori ekonomik “LIQENI VII” sh.p.k. në përmbushje të kriterit të mësipërm ka deklaruar në shtojcën nr.10 se disponojnë mjetet e mëposhtëme:

1. Kamion me targa AA269FC me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 9.8 Ton(do konsiderohet i rregullt dhe do futet në kategorinë me kapacitet mbajtës 5-10 ton)
2. Kamion me targa AA564PZ me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 17.7Ton(do të konsiderohet i rregullt i përket kategorisë kamion me kapacitet min 15 ton dhe max 20 T)
3. Kamioncinë me targa DR9043D me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 1.7Ton(do të konsiderohet i rregullt i përket kategorisë kamion me kapacitet min 1.5 ton dhe max 2 T)
4. Auto vinç me targa AA247OI me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 7.7 Ton(do konsiderohet i rregullt dhe do futet në kategorinë me kapacitet mbajtës 5-10 ton)
5. Kamion me targa AA207JH me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 24 Ton
6. Kamioncinë me targa AA638KT me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 0.8 Ton

Autoriteti Kontraktor ka kërkuar ti vihet në dispozicion dy kamiona vetëshkarkues kapaciteti

mbajtës duhet të jetë minimum 15 ton dhe maximum 20 ton secili kamion për ekzekutimin e kontratës. Operatori Ekonomik në përmbushje të këtij kriteri nga dy kamiona ka paraqitur vetëm një kamion me tonazhin e kërkuar nga AK.

Pra sa më sipër cituar dokumentacioni i paraqitur nga Operatori Ekonomik lidhur me shtojcën 10 , është i paplotë lidhur me kamionat vetshkarkues me kapacitet mbajtes minimumi 15 ton dhe maksimumi 20 ton për secilin kamion te kerkuar nga AK (2 cope), për rrjedhojë i pavlefshëm.

Autoriteti Kontraktor ka kërkuar ti vihet në dispozicion dy kamionçina vetshkarkues kapaciteti mbajtës duhet të jetë minimum 1 ton dhe maximum 2 ton secili kamionçinë për ekzekutimin e kontratës. Operatori Ekonomik në përmbushje të këtij kriteri ka paraqitur vetëm një kamionçinë me tonazhin e kërkuar nga AK.

Pra sa më sipër cituar dokumentacioni i paraqitur nga Operatori Ekonomik lidhur me shtojcën 10 , është i paplotë lidhur me kamionçinat me kapacitet mbajtes minimumi 1 ton dhe maksimumi 2 ton për secilën kamionçinë te kerkuar nga AK (2 cope) , për rrjedhojë i pavlefshëm

Pra sa më sipër cituar dokumentacioni i paraqitur nga Operatorëve Ekonomik lidhur me shtojcën 10 , është i paplotë, për rrjedhojë i pavlefshëm

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të Nenit 53 pika 5, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për Prokurimin publik” (i ndryshuar) dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu VII, Neni 66 pika 3, e shpall të pavlefshme këtë ofertë pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

4. Oferta e paraqitur nga operatori ekonomik “S I R E T A 2F” sh.p.k. me vlerë të ofertës 19.999.999 (nëntëmbëdhjetë milion e nëntëqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e nëntë) lekë pa TVSH.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave pasi realizoi kontrollin për gabime aritmetike të ofertës së paraqitur në tender në mbështetje të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik” I ndryshuar neni 66, konstatoi se oferta është paraqitur pa gabime aritmetike në vlera.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në mbështetje të nenit 53 të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, për “Prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe Kreut VII, neni 66, pika 3 të VKM Nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar si dhe dokumentave të tenderit të miratuara, vijoi me shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertës së paraqitur nga ky Operator ekonomik, nga ku rezultoi si më poshtë:

- *Autoriteti kontraktor në Dokumentat Standarte të Tenderit tek Kriteret e Veçanta të Kualifikimit/ Kapaciteti teknik ka kërkuar si më poshtë:*

18.Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratë (Shtojca 10).

Mjetet	Sasia	Gjendja
Kamion vetshkarkues (kapaciteti mbajtës minimum 5(pese) ton dhe maksimumi 10(dhjete) ton për secilin kamion	2 copë	Pronësi ose me qera
Fadrome me goma	1 copë	Pronësi ose me qera

Eskavator me goma 0.25 m3	1 copë	Pronësi ose me qera
Kamion vetëshkarkues (kapaciteti mbajtës minimum 15(pesëmbëdhjetë) ton dhe maksimumi 20(njëzetë) ton për secilin kamion	2 copë	Pronësi ose me qera
Autobetoniere	3 copë	Pronësi ose me qera
Autovinc	1 cope	Pronësi ose me qera
Pompë uji	1 copë	Pronësi ose me qera
Kamionçinë (kapaciteti mbajtës minimum 1(nje) ton dhe maksimumi 2(dy) ton për secilin kamionçinë	2 cope	Pronësi ose me qera
Prerese asfalti	2 cope	Pronësi ose me qera
Rrul	1 cope	Pronësi ose me qera

Bashkimi I Operatorëve ekonomik “Sireta 2F” në përmbushje të kriterit të mësipërm ka deklaruar në shtojcën nr.10 se disponojnë mjetet e mëposhtme:

1. Kamion me targa AA711HJ me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 17.5 Ton(do konsiderohet i rregullt dhe do futet në kategorinë me kapacitet mbajtës 15-20 ton)
2. Kamion me targa AA586IC me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 16.7 Ton (do konsiderohet i rregullt dhe do futet në kategorinë me kapacitet mbajtës 15-20 ton)
3. Kamion me targa AA735PY me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 11.9 Ton
4. Kamion me targa AA798CP me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 6.6 Ton (do konsiderohet i rregullt dhe do futet në kategorinë me kapacitet mbajtës 5-10 ton)
5. Kamioncinë me targa AA698MZ me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 3.1 Ton
6. Kamion me targa AA548NX me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 4.9 Ton (do konsiderohet i rregullt dhe do futet në kategorinë me kapacitet mbajtës 5-10 ton)
7. Kamioncinë me targa AA907DD me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 1 Ton(do konsiderohet i rregullt dhe do futet në kategorinë me kapacitet mbajtës 1-2 ton)

Autoriteti Kontraktor ka kërkuar ti vihet në dispozicion dy kamionçina kapaciteti mbajtës duhet të jetë minimum 1 ton dhe maximum 2 ton secili kamion për ekzekutimin e kontratës. Operatori Ekonomik në përmbushje të këtij kriteri nga dy kamionçina ka paraqitur vetëm një kamionçinë me tonazhin e kërkuar nga AK.

Pra sa më sipër cituar dokumentacioni i paraqitur nga Operatori Ekonomik lidhur me shtojcën 10 , është i paplotë lidhur me kamionçinat me kapacitet mbajtës minimumi 1 ton dhe maksimumi 2 ton për secilin kamion te kërkuar nga AK (2 cope), për rrjedhojë i pavlefshëm.

Pra sa më sipër cituar dokumentacioni i paraqitur nga Operatorëve Ekonomik lidhur me shtojcën

10 , është i paplotë, për rrjedhojë i pavlefshëm

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të Nenit 53 pika 5, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për Prokurimin publik” (i ndryshuar) dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu VII, Neni 66 pika 3, e shpall të pavlefshme këtë ofertë pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

5. Oferta e paraqitur nga Operatori ekonomik “Gjikuria” sh.p.k. me vlerë të ofertës 20.093.703 (njëzetë million e nëntëdhjetë e tre mijë e shtatëqind e tre) lekë pa tvsh.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave pasi realizoi kontrollin për gabime aritmetike të ofertës së paraqitur në tender në mbështetje të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik” I ndryshuar neni 66, konstatoi se oferta është paraqitur pa gabime aritmetike në vlera.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në mbështetje të nenit 53 të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, për “Prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe Kreut VII, neni 66, pika 3 të VKM Nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar si dhe dokumentave të tenderit të miratuara, vijoi me shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertës së paraqitur nga ky Operator ekonomik, nga ku rezultoi si më poshtë:

Autoriteti kontraktor në Dokumentat Standarte të Tenderit tek Kriteret e Veçanta të Kualifikimit/ Kapaciteti teknik ka kërkuar si më poshtë:

18.Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratë (Shtojca 10).

Mjetet	Sasia	Gjendja
Kamion vetëshkarkues (kapaciteti mbajtës minimum 5(pese) ton dhe maksimumi 10(dhjetë) ton për secilin kamion	2 copë	Pronësi ose me qera
Fadrome me goma	1 copë	Pronësi ose me qera
Eskavator me goma 0.25 m3	1 copë	Pronësi ose me qera
Kamion vetëshkarkues (kapaciteti mbajtës minimum 15(pesëmbëdhjetë) ton dhe maksimumi 20(njëzetë) ton për secilin kamion	2 copë	Pronësi ose me qera
Autobetoniere	3 copë	Pronësi ose me qera
Autovinc	1 cope	Pronësi ose me qera
Pompë uji	1 copë	Pronësi ose me qera
Kamionçine (kapaciteti mbajtës minimum 1(nje) ton dhe maksimumi 2(dy) ton për secilin kamionçinë	2 cope	Pronësi ose me qera
Prerese asfalti	2 cope	Pronësi ose me qera
Rrul	1 cope	Pronësi ose me qera

Operatori ekonomik “Gjikuria” sh.p.k. në përmbushje të kriterit të mësipërm ka deklaruar në shtojcën nr.10 se disponojnë mjetet e mëposhtëme:

- Kamion me targa AA230 NZ me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 7.4 Ton. Më datën 21.05.2018 pranë UKT sha është zhvilluar procedura me objekt prokurimi ;Rikonstruksion dhe rrethimi i Depove në ujësjellësat rajonal (FAZA 1) , ku theksojmë se operator pjesmarrës në garë ka qënë shoqëria ANTE-GROUP e cila në shtojcën nr.10 të makinerive ka paraqitur kamion me targa AA230 NZ të siguruar nëpërmjet kontratës së vlefshme të qerasë me shoqërinë Gjikuria me nr. Kontrate 355 rep dhe 102/1 kol. Për sa kohë që pranë AK , UKT sha nuk ka dalë njoftim fituesi për procedurën në fjalë si dhe nuk është paraqitur në sistemin elektronik të app-së një kontratë e prishjes së marrëveshjes së qerasë nëpërmjet dy operatorëve rezulton që kontrata e qerasë është e vlefshme dhe operatori ekonomik Gjikuria nuk duhet ta paraqesë këtë mjet në shtojcën nr.10.
- Kamion me targa AA840 TI me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 7.6 Ton Më datën 21.05.2018 pranë UKT sha është zhvilluar procedura me objekt prokurimi ;Rikonstruksion dhe rrethimi i Depove në ujësjellësat rajonal (FAZA 1) , ku theksojmë se operator pjesmarrës në garë ka qënë shoqëria ANTE-GROUP e cila në shtojcën nr.10 të makinerive ka paraqitur kamion me targa AA840 TI të siguruar nëpërmjet kontratës së vlefshme të qerasë me shoqërinë Gjikuria me nr. Kontrate 355 rep dhe 102/1 kol. Për sa kohë që pranë AK , UKT sha nuk ka dalë njoftim fituesi për procedurën në fjalë si dhe nuk është paraqitur në sistemin elektronik të app-së një kontratë e prishjes së marrëveshjes së qerasë nëpërmjet dy operatorëve rezulton që kontrata e qerasë është e vlefshme dhe operatori ekonomik Gjikuria nuk duhet ta paraqesë këtë mjet në shtojcën nr.10.
- Kamion me vinç me targa AA348 IV me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 13.7 Ton
- KAMION me targa AA851 RM me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 17.2 Ton(do të konsiderohet i rregullt i përket kategorisë kamion me kapacitet min 15 ton dhe max 20 T)
- Kamioncine me targa AA087PF me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 1.35 Ton. (do të konsiderohet i rregullt i përket kategorisë kamionçinë me kapacitet min 1 ton dhe max 2 T)
- Kamioncine me targa AA846IZ me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 1Ton. (do të konsiderohet i rregullt i përket kategorisë kamionçinë me kapacitet min 1 ton dhe max 2 T)

Gjithashtu shoqëria Gjikuria shpk ka paraqitur në shtojcën nr.10 autovinç me targa AA391DD por nga verifikimi që iu bë nga KVO dokumentave të paraqitura në sistemin elektronik të app-së rezultoi se shoqëria nuk ka paraqitur dokumentacion lidhur me këtë mjet.

Autoriteti Kontraktor ka kërkuar ti vihet në dispozicion dy kamiona vetëshkarkues kapaciteti mbajtës duhet të jetë minimum 5 ton dhe maximum 10 ton secili kamion për ekzekutimin e kontratës. Operatori Ekonomik në përmbushje të këtij kriteri nga dy kamiona nuk ka paraqitur asnjë kamion me tonazhin e kërkuar nga AK.

Pra sa më sipër cituar dokumentacioni i paraqitur nga Operatori Ekonomik lidhur me shtojcën 10, është i paplotë lidhur me kamionat vetshkarkues me kapacitet mbajtës minimumi 5 ton dhe maksimumi 10 ton secili te kerkuar nga AK (2 cope), për rrjedhojë i pavlefshëm.

Autoriteti Kontraktor ka kërkuar ti vihet në dispozicion dy kamiona vetëshkarkues kapaciteti mbajtës duhet të jetë minimum 15 ton dhe maximum 20 ton secili kamionçinë për ekzekutimin e kontratës. Operatori Ekonomik në përmbushje të këtij kriteri nga dy kamiona , shoqëria ka paraqitur

vetëm një kamion me tonazhin e kërkuar nga AK

Pra sa më sipër cituar dokumentacioni i paraqitur nga Operatori Ekonomik lidhur me shtojcën 10, është i paplotë lidhur me kamionat me kapacitet mbajtes minimumi 15 ton dhe maksimumi 20 ton të kërkuar nga AK (2 cope) , për rrjedhojë i pavlefshëm.

Gjithashtu shoqëria nuk ka paraqitur asnjë autovinç siç edhe është kërkuar në DST nga AK.

Pra sa më sipër cituar dokumentacioni i paraqitur nga Operatorëve Ekonomik lidhur me shtojcën 10 , është i paplotë, për rrjedhojë i pavlefshëm

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të Nenit 53 pika 5, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për Prokurimin publik” (i ndryshuar) dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu VII, Neni 66 pika 3, e shpall të pavlefshme këtë ofertë pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

6. Oferta e paraqitur nga Operatori ekonomik “REJ” sh.p.k. me vlerë të ofertës 20.547.237 (njëzetë milion e pesëqind e dyzetë e shtatë mijë e dyqind e tridhjetë e shtatë) lekë pa tvsh.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave pasi realizoi kontrollin për gabime aritmetike të ofertës së paraqitur në tender në mbështetje të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik” I ndryshuar neni 66, konstatoi se oferta është paraqitur pa gabime aritmetike në vlera.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në mbështetje të nenit 53 të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, për “Prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe Kreut VII, neni 66, pika 3 të VKM Nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar si dhe dokumentave të tenderit të miratuara, vijoi me shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertës së paraqitur nga ky Operator ekonomik, nga ku rezultoi si më poshtë:

Autoriteti kontraktor në Dokumentat Standarte të Tenderit tek Kriteret e Veçanta të Kualifikimit/ Kapaciteti teknik ka kërkuar si më poshtë:

18.Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratë (Shtojca 10).

Mjetet	Sasia	Gjendja
Kamion vetëshkarkues (kapaciteti mbajtës minimum 5(pese) ton dhe maksimumi 10(dhjetë) ton për secilin kamion	2 copë	Pronësi ose me qera
Fadrome me goma	1 copë	Pronësi ose me qera
Eskavator me goma 0.25 m3	1 copë	Pronësi ose me qera
Kamion vetëshkarkues (kapaciteti mbajtës minimum 15(pesëmbëdhjetë) ton dhe maksimumi 20(njëzetë) ton për secilin kamion	2 copë	Pronësi ose me qera
Autobetoniere	3 copë	Pronësi ose me qera
Autovinc	1 cope	Pronësi ose me qera
Pompë uji	1 copë	Pronësi ose me qera
Kamionçine (kapaciteti mbajtës minimum 1(nje) ton dhe maksimumi 2(dy) ton për	2 cope	Pronësi ose me qera

secilin kamionçinë		
Prerese asfalti	2 cope	Pronësi ose me qera
Rrul	1 cope	Pronësi ose me qera

Operatori ekonomik “REJ” sh.p.k. në përmbushje të kriterit të mësipërm ka deklaruar në shtojcën nr.10 se disponojnë mjetet e mëposhtëme:

- Kamion me targa AA117NT me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 10.6 Ton. (do të konsiderohet i rregullt i përket kategorisë kamion me kapacitet min 5 ton dhe max 10 T)
- Rimorkio me targa ADR398 me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 27.3 Ton.
- Kamion me targa AA354PT me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 0 ton
- Rimorkio me targa ADR405 me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 27 TON
- Kamion me targa AA997MY me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 16.2 Ton (do të konsiderohet i rregullt i përket kategorisë kamion me kapacitet min 15 ton dhe max 20 T)
- Kamioncine me targa AA 558HF me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 1.4 Ton. (do të konsiderohet i rregullt i përket kategorisë kamionçinë me kapacitet min 1 ton dhe max 2 T)
- Kamioncine me targa PG5886B me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 1.6 Ton. (do të konsiderohet i rregullt i përket kategorisë kamionçinë me kapacitet min 1 ton dhe max 2 T)

Autoriteti Kontraktor ka kërkuar ti vihet në dispozicion dy kamiona vetëshkarkues kapaciteti mbajtës duhet të jetë minimum 5 ton dhe maximum 10 ton secili kamion për ekzekutimin e kontratës. Operatori Ekonomik në përmbushje të këtij kriteri nga dy kamiona ka paraqitur vetëm një kamion me tonazhin e kërkuar nga AK.

Pra sa më sipër cituar dokumentacioni i paraqitur nga Operatori Ekonomik lidhur me shtojcën 10, është i paplotë lidhur me kamionat vetëshkarkues me kapacitet mbajtës minimumi 5 ton dhe maksimumi 10 ton secili të kërkuar nga AK (2 cope), për rrjedhojë i pavlefshëm.

Autoriteti Kontraktor ka kërkuar ti vihet në dispozicion dy kamiona vetëshkarkues kapaciteti mbajtës duhet të jetë minimum 15 ton dhe maximum 20 ton secili kamionçinë për ekzekutimin e kontratës. Operatori Ekonomik në përmbushje të këtij kriteri nga dy kamiona, shoqëria ka paraqitur vetëm një kamion me tonazhin e kërkuar nga AK

Pra sa më sipër cituar dokumentacioni i paraqitur nga Operatori Ekonomik lidhur me shtojcën 10, është i paplotë lidhur me kamionat me kapacitet mbajtës minimumi 15 ton dhe maksimumi 20 ton të kërkuar nga AK (2 cope), për rrjedhojë i pavlefshëm.

Pra sa më sipër cituar dokumentacioni i paraqitur nga Operatorëve Ekonomik lidhur me shtojcën 10, është i paplotë, për rrjedhojë i pavlefshëm

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të Nenit 53 pika 5, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për Prokurimin publik” (i ndryshuar) dhe Vendimit të Këshillit të

Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu VII, Neni 66 pika 3, e shpall të pavlefshme këtë ofertë pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

7. Oferta e paraqitur nga Operatori ekonomik “KOLA INVEST ” shpk me vlerë të ofertës 0 (zero) lekë pa TVSH

Pas hapjes së ofertave, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konstatoi se shoqëria “KOLA INVEST ” shpk ka paraqitur në sistemin elektronik dokumentacionin ligjor e teknik të kërkuar në Shtojcën 12 por nuk ka paraqitur ofertën ekonomik me preventivin bashkëlidhur të dokumenteve të tenderit për këtë procedurë.

Ky fakt i konstatuar nga KVO-ja u regjistrua në procesverbalin e vlerësimit të Ofertave. Mungesa e ofertës ekonomike u konfirmua nga të gjithë anëtarët e KVO-së në tërësi.

Përsa më sipër, Operatori Ekonomik “KOLA INVEST ” shpk s’kualifikohet pasi nuk ka paraqitur ofertën ekonomike sipas shtojcës 1 , të përcaktuara në dokumentat standarte të tenderit për këtë procedurë.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të pikës 5, të nenit 53, të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, për “Prokurimin publik”, i ndryshuar dhe mbështetje të Kreu VII, neni 66, pika 3, të VKM nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e shpall të pavlefshme këtë ofertë pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

8. Oferta e paraqitur nga Operatori ekonomik “FLED” sh.p.k. me vlerë të ofertës 21.620.708 (njëzetë e një million e gjashtëqind e njëzetë mijë e shtatëqind e tetë) lekë pa tvsh.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave pasi realizoi kontrollin për gabime aritmetike të ofertës së paraqitur në tender në mbështetje të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik” I ndryshuar neni 66, konstatoi se oferta është paraqitur pa gabime aritmetike në vlera.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në mbështetje të nenit 53 të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, për “Prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe Kreut VII, neni 66, pika 3 të VKM Nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar si dhe dokumentave të tenderit të miratuara, vijoi me shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertës së paraqitur nga ky Operator ekonomik, nga ku rezultoi si më poshtë:

- *Autoriteti kontraktor në Dokumentat Standarte të Tenderit tek Kriteret e Veçanta të Kualifikimit/ Kapaciteti teknik ka kërkuar si më poshtë:*

5. Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar staf teknik për kryerjen e të gjitha punimeve në këtë objekt, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, diplomë, CV, librezat e punës, si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë për të paktën 3 (tre) muajt e fundit stafi inxhinierik si më poshtë:

- 1(një) inxhinierë Ndërtimi
- 1(një) inxhinier Elektrik
- 1(një) inxhinier Hidroteknik
- 1(një) Inxhinier topograf
- 1(një) inxhinier Mjedisi (i pajisur me çertifikatë lëshuar nga Ministria e Mjedisit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis)

Operatori ekonomik "FLED" sh.p.k në përmbushje të kriterit të mësipërm ka paraqitur Inxhinieren e mjedisit B.A e cila figuron në listpagesat e shoqërisë për tre muajt e fundit por nuk ka paraqitur për zonjën me inicialet B.A çertifikatë lëshuar nga Ministria e Mjedisit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis.

Sa më sipër dokumentacioni I paraqitur nga shoqëria "FLED" shpk në lidhje me pikën 1(një) inxhinier Mjedis (i pajisur me çertifikatë lëshuar nga Ministria e Mjedisit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis) është I paplotë për rrjedhojë I parregullt

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të Nenit 53 pika 5, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006, "Për Prokurimin publik" (i ndryshuar) dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", Kreu VII, Neni 66 pika 3, **e shpall të pavlefshme** këtë ofertë pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë Bashkimi i Operatorve ekonomik, "Vuthaj shpk & Ndrejoni shpk" sh.p.k, Përfaqësuar me prokurë të posaçme nr.4126 rep. dhe nr.3351 kol. Datë 22.05.2018 nga shoqëria "Vuthaj shpk me NIPT K67812301C me administrator, Z.Fatmir Vuthaj me vlerë të ofertës pa tvsh = 20.492.945 (njëzetë milion e katërqind e nëntëdhjetë e dy mijë e nëntëqind e dyzetë e pesë) lekë, **se është identifikuar si oferta e suksesshme.**

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Ujësjetës Kanalizime Tiranë sh.a me adresë rruga "5 Maji" pranë Medresesë, Tiranë, me nr tel: +355 4 2225572, sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve nga dita e marrjes të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 05.06.2018

Ankesa: Është paraqitur ankesa nga OE. "B-93" shpk me Nr. 15396 Prot. Datë 08.06.2018, të cilës i është kthyer përgjigje me me ane të shkresës Nr. 15396/1 Prot. Datë 11.06.2018 duke mos pranuar ankesën e paraqitur prej tij.

Gjatë afatit kohor për ankesa në KPP nuk është paraqitur ankesë.